


Indeksi i Transparencës Buxhetore të Komunave **2022**



Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	4
Metodologjia	4
Gjetjet kryesore për vitin 2022	6
Analiza e performancës së komunave – indeksi i vitit 2022 krahasuar me indeksin e vitit 2021	10
Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor	11
Përfundim dhe rekomandime	13
Anekset	14

Drenas	15
Klinë	16
Lipjan	17
Mitrovicë e Jugut	18
Prizren	19
Rahovec	20
Skënderaj	21
Hani i Elezit	22
Vushtrri	23
Podujevë	24
Suharekë	25
Gjakovë	26
Kamenicë	27
Istog	28
Prishtinë	29
Junik	30
Gjilan	31
Pejë	32
Ferizaj	33
Malishevë	34
Dragash	35
Shtime	36
Deçan	37
Graçanicë	38
Kaçanik	39
Obliq	40
Viti	41
Fushë Kosovë	42
Mamushë	43
Ranillug	44
Novobërdë	45
Klllokot	46
Shtërpçë	47
Partesh	48

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport paraqet vlerësimin e shtatë të Institutit GAP mbi transparencën buxhetore të komunave në Kosovë. Nga viti 2017, Instituti GAP ka bërë vlerësimin e përvitshëm të komunave në bazë të transparencës së treguar në publikimin e dokumenteve buxhetore dhe dëgjimeve buxhetore të mbajtura me qytetarë. Në vitin 2022, tranparenca buxhetore e komunave ishte në nivelin më të lartë që nga publikimi i parë i indeksit, me një mesatare prej 62.8 pikësh. Gjatë vitit 2022, komunat kanë publikuar 258 dokumente buxhetore dhe kanë organizuar 130 dëgjime buxhetore. Nga gjithsej 100 pikë të vlerësimit, 28 komuna (73.7%) kanë arritur të kenë më shumë se 50 pikë.

Si rezultat i rritjes së numrit të dokumenteve buxhetore të publikuara, dëgjimeve buxhetore të mbajtura dhe përmirësimit të formatit të publikimit të dokumenteve, 25 komuna kanë shënuar progres në vlerësimin me pikë, katër komuna kanë shënuar regres, ndërsa komunat e tjera kanë pikë të njëjta sikur vitin e kaluar. Progresin më të madh me pikë në indeksin e vitit 2022 e kanë shënuar komunat e Skënderajit (+42.5 pikë), Prizrenit (+32.5 pikë), Vushtrrisë (+31.5 pikë), Drenasit (+30 pikë), Klinës (+30 pikë) dhe e Podujevës (+30 pikë). Gjithashtu, komunat kanë shënuar progres të madh edhe në publikimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, ku gjithsej 22 komuna (dhjetë më shumë sesa vitin e kaluar) e kanë publikuar në ueb-faqet e tyre apo e kanë dërguar përmes kërkesës këtë dokument të rëndësishëm buxhetor.

Dokumentet buxhetore të publikuara më së shumti nga ana e komunave gjatë vitit 2022 janë korniza afatmesme buxhetore dhe raporti financiar për tremujorin e dytë.

Bazuar në formatin e publikimit, komuna e vetme e cila i ka të publikuara të gjitha dokumentet buxhetore në formatin 'Excel/Word' është ajo e Mitrovicës së Jugut, ndërsa Komuna e Obliqit është komuna e vetme që i ka të publikuara të gjitha dokumentet në formatin 'dokument i skanuar'.

Nga 38 komuna, vetëm 15 prej tyre (39%) i kanë publikuar të gjitha dokumentet buxhetore që obligohen t'i publikojnë sipas Udhëzimit administrativ të MAPL-së për transparencë buxhetore në komuna. Ndërsa, në kërkesat e Institutit GAP për qasje në dokumentet buxhetore, 13 komuna nuk kanë kthyer përgjigje.

Metodologjia

Indeksi i transparencës buxhetore të komunave i Institutit GAP për vitin 2022 përbëhet nga 100 pikë të shpërndara në dokumentet buxhetore, rregulloret, listat e përfituesve të subvencioneve dhe dëgjimet publike buxhetore. Instituti GAP bën vlerësim të dokumenteve buxhetore të publikuara në ueb-faqet e komunave në Kosovë. Numri i pikëve për një dokument është i njëjtë për të gjitha komunat dhe këto pikë janë vendosur sipas vlerësimit të Institutit GAP duke u bazuar në peshën që kanë dokumentet buxhetore në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në nivelin lokal. Dokumentet e publikuara në formatin më lehtë të lexueshëm si Excel apo Word marrin numrin maksimal të pikëve, dokumentet në formatin PDF marrin 30% pikë më pak, ndërsa dokumentet e skanuara 50% pikë më pak. Nëse një dokument buxhetor nuk është publikuar në ueb-faqen zyrtare të komunës, por është dërguar përmes email-it, atëherë dokumenti vlerësohet me 70% pikë më pak. Përfshirje në këtë rast bëjnë vetëm dokumentet si kartela analitike e kontos, kontratat e nënshkruara dhe lista e përfituesve të subvencioneve të cilat edhe nëse dërgohen vetëm në kërkesë përmes email-it nuk i ulen pikët për 70% për shkak se këto dokumente ende nuk janë obligime ligjore për publikim. Edhe këtë vit, ngjashëm sikur në vitin e kaluar, Instituti GAP ka analizuar se sa nga komunat kanë të publikuara dokumente për buxhetim të përgjegjshëm gjinor, ndonëse ky dokument ende nuk është futur në vlerësimin e komunave për transparencë buxhetore.

Komunat që kanë publikuar të gjitha dokumentet në faqen e internetit në formatin 'Excel/Word' dhe kanë organizuar të paktën katër dëgjime buxhetore arrijnë të vlerësohen me maksimumin e pikëve (Tabela 1). Mbledhja e të dhënave për publikimin e dokumenteve është bërë duke kërkuar nga komunat që të plotësojnë një pyetësor me linqet/vegëzat e dokumenteve të publikuara në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Tabela 1. Vlerësimi me pikë i komunave për publikimin e dokumenteve sipas Institutit GAP

Dokumenti	Excel/Word	PDF	Dokument i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2022	5	3.5	2.5	1.5
Raporti financiar TM 2 për vitin 2022	5	3.5	2.5	1.5
Raporti financiar TM 3 për vitin 2022	5	3.5	2.5	1.5
Raporti vjetor financiar për vitin 2022	15	10.5	7.5	4.5
Buxheti i planifikuar për vitin 2023	5	3.5	2.5	1.5
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5	5	5	1.5
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2022	10	7	5	5
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2022	20	14	10	10
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	2.5	2.5	2.5
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	2.5	2.5	2.5
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	2.5	2.5	2.5
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2022	2.5	2.5	2.5	2.5
Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025	10	7	5	3
Kontratat e nënshkruara 2022	10	10	10	10
Gjithsej	100	77.5	62.5	50

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor

Burimi: Instituti GAP

Në fund të muajit maj 2023 Instituti GAP ka dërguar kërkesa te zyret komunale për komunikim me publikun dhe monitorimi i faqeve të komunave ka përfunduar në qershor 2023. Për komunat të cilat nuk janë përgjigjur në kërkesën tonë, vlerësimi është bërë në bazë të informatave që i kemi gjetur në ueb-faqet e tyre, duke mos marrë parasysh dokumentet që nuk janë gjetur me tri klikime dhe në fushën përkatëse të destinuar për publikimin e raporteve të buxhetit.

Instituti GAP ka kërkuar qasje në dokumente nga 38 komunat e Kosovës, 25 prej tyre janë përgjigjur pozitivisht, 10 komuna nuk janë përgjigjur në kërkesë dhe tek tri komuna të tjera (Leposaviçi, Zubin Potoku dhe Zveçani) nuk është dërguar kërkesa për shkak të ndryshimit të kryetarëve dhe administratës, si dhe situatës së krijuar në pjesën veriore të vendit. Gjetja e dokumenteve buxhetore ka qenë sfiduese për disa komuna, pasi dokumentet nuk janë vendosur në kategorinë e destinuar për to. Gjithashtu, për shkak të problemeve për qasje në ueb-faqet e komunave si rezultat i shpejtësisë së dobët të tyre apo mosfunksionimit nevojiten afërsisht tre minuta kohë për hapjen e një dokumenti buxhetor.

Gjetjet kryesore për vitin 2022

E drejta e qytetarëve për të pasur qasje në dokumente publike është e drejtë e garantuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për qasje në dokumente publike. Ligji për qasje në dokumente publike lejon qasjen në dokumente që kanë të bëjnë me shpenzimin e parasë publike dhe i obligon institucionet që të publikojnë dokumente që lidhen me shpenzimet e parasë publike në formatin elektronik dhe të dhëna të hapura për publikun.¹ Institucionet duhet të publikojnë çdo dokument publik të përfunduar, pavarësisht nëse qytetarët kanë bërë kërkesë për qasje në dokumente apo jo. Për më tepër, këto të dhëna duhet të jenë të hapura në mënyrë që t'u mundësohet qytetarëve përdorimi dhe krahasimi i tyre.

Në anën tjetër, Ligji për menaxhimin e financave publike bën përgjegjës kryetarët e komunave për publikimin e raporteve financiare në ueb-faqen e komunës dhe për të mbajtur dëgjime buxhetore me qytetarë.² Gjithashtu, Udhëzimi administrativ i Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal (MAPL) për transparencë në komuna kërkon të paktën dy dëgjime publike me qytetarë brenda vitit dhe takime shtesë për buxhet dhe çështje tjera komunale.³ Në disa raste, qarkoret buxhetore të hartuara nga Ministria e Financave e obligojnë kryetarin e komunës që të shqyrtojë buxhetin me qytetarë. Përveç kësaj, Udhëzimi administrativ i MAPL-së kërkon nga komunat e Kosovës që të publikojnë dokumente buxhetore si planin e buxhetit dhe planet investuese, raportet tre mujore të shpenzimeve, kornizën afatmesme buxhetore (KAB), raportin përmbledhës të buxhetit të komunës për vitin e kaluar fiskal, si dhe raportin e auditorit të përgjegjshëm mbi buxhetin e komunës për vitin e kaluar fiskal.⁴

Transparenca buxhetore e komunave në vitin 2022 është në një nivel më të lartë se në vitet e kaluara. Përderisa në vitin 2021 mesatarja e pikëve ishte 53.1 pikë, në indeksin e vitit 2022 kjo mesatare shkon në 62.8 pikë. Gjatë vitit 2022, gjithsej 22 komuna (58 %) e kanë kaluar nivelin mesatar të pikëve të indeksit. Maksimumin e pikëve të indeksit prej 100 pikë për vitin 2022 e kanë arritur shtatë komuna: Drenasi, Klina, Lipjani, Mitrovica e Jugut, Prizreni, Rahoveci dhe Skënderaj. Këto shtatë komuna kanë publikuar të gjitha dokumentet buxhetore në formatin 'Excel' ose 'Word', me përjashtim të dokumenteve me përmbajtje tekstuale që janë publikuar edhe në formate tjera si 'PDF' apo 'dokument i skanuar'. Transparenca të lartë buxhetore kanë treguar edhe Komuna e Hanit të Elezit (95 pikë), si dhe Komuna e Vushtrrisë (93.5 pikë). Këto dy komuna, ndonëse i kanë publikuar të gjitha dokumentet buxhetore, për shkak të formatit të publikimit të disa dokumenteve nuk kanë arritur pikët maksimale të indeksit. Gjithsej nëntë komuna (23.7%) bëjnë pjesë në kuartilin e lartë, dhjetë komuna (26.3%) bëjnë pjesë në kuartilin e mesëm të lartë, nëntë

1 Ligji nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike. Burimi: <https://bit.ly/3A9JcMM>

2 Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Neni 61. Burimi: <http://bit.ly/2h3BfRW>


3 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Udhëzim administrativ nr. 03/2020 për transparencë në komuna. Burimi: <https://bit.ly/3ElevHh>

4 Ibid.

komuna (23.7%) në kuartilin e mesëm të ulët, dhe dhjetë komuna (26.3%) në kuartilin e ulët. Kuartilet janë koncept statistikor që përdoren për të ndarë një set të dhënash në katër pjesë thuajse të barabarta bazuar në renditjen e tyre. Përmes kuartileve ne mund të kuptojmë se sa të shpërndara janë të dhënat brenda një seti të caktuar dhe si mund të analizohen ato. Këtë vit për shkak të numrit më të madh të pikëve që i kanë përfituar komunat, të dhënat janë të anuara drejt skajit të sipërm. Kuartili i lartë përfshin komunat që kanë mbledhur më shumë se 92.5 pikë, kuartili i mesëm i lartë përfshin komunat që kanë mbledhur mbi 70.5 pikë deri në 92.5 pikë, kuartili i mesëm i ulët përfshin komunat që kanë mbledhur mbi 40 deri në 70.5 pikë, ndërsa kuartili i ulët komunat që kanë mbledhur nga 0 deri në 40 pikë.

Komuna e Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit janë vlerësuar me zero pikë në indeks, meqë nuk kanë publikuar asnjë dokument buxhetor të vitit 2022 në ueb-faqet e tyre zyrtare dhe nuk janë përgjigjur në kërkesën e Institutit GAP për qasje në dokumentet buxhetore.

Figura 1. Indeksi për transparencë buxhetore komunale 2022



Leposaviqi / Partesh / Zubin Potoku / Zveçani


Bazuar në Indeksin e GAP për transparencë buxhetore, komunat kanë publikuar gjithsej 258 dokumente buxhetore (pa i përfshirë këtu kontratat e nënshkruara), 32 dokumente më shumë sesa vitin e kaluar. Gjithashtu, gjatë vitit 2022 janë mbajtur 130 dëgjime buxhetore (24 më shumë sesa në vitin 2021). Numri më i madh i dokumenteve buxhetore janë të publikuara në formatin 'Excel/Word', përkatësisht 140 dokumente (61%), 75 dokumente buxhetore janë publikuar në formatin 'dokument i skanuar' (31%), 17 dokumente buxhetore janë të publikuara në formatin 'PDF' (7%), ndërsa përmes kërkesës kemi pranuar vetëm 3 dokumente buxhetore (1%).

Figura 2. Formati i dokumenteve buxhetore të publikuara



Në indeksin buxhetor të vitit 2022, dokumentet që janë publikuar më së shumti nga komunat kanë qenë korniza afatmesme buxhetore (2023–2025), si dhe raporti financiar për tremujorin e dytë (TM2). Dokumentet më të publikuara në formatin 'Excel/Word' në përqindje janë kartela analitike e kontos, raporti financiar për tremujorin e tretë dhe raporti vjetor financiar. Dokumenti buxhetor që është publikuar më së shumti në formatin 'PDF' nga ana e komunave është buxheti i planifikuar për vitin 2023. Në formatin 'dokument i skanuar' më shumë është publikuar korniza afatmesme buxhetore dhe lista e përfituesve të subvencioneve e cila njëherit shënon edhe dokumentin më të dërguar përmes kërkesës së bashku me kartelën analitike të kontos.

Figura 3. Përqindja e komunave që kanë publikuar dokumentet që përmban indeksi



Sipas Udhëzimit administrativ të MAPL-së për transparencë në komuna, komunat në mënyrë sistematike obligohen të publikojnë raportet tre mujore dhe vjetore të buxhetit, planin e buxhetit për vitin e ardhshëm dhe kornizën afatmesme buxhetore. Megjithatë, jo të gjitha komunat e zbatojnë këtë rregull. Nga dokumentet buxhetore të kërkuara, 31 komuna kanë publikuar raportin financiar për TM1, 32 komuna kanë publikuar raportin financiar për TM2, ndërsa 29 komuna kanë publikuar raportin financiar për TM3. Raporti vjetor financiar është i publikuar nga 29 komuna, ndërsa korniza afatmesme buxhetore është publikuar nga 32 komuna. Dokumenti më i detajuar buxhetor (kartela analitike e kontos) i cili njëherit shënon edhe dokumentin më të vlerësuar me pikë në indeksin e GAP për transparencë buxhetore, edhe këtë vit, ngjashëm si në vitet e kaluara, është publikuar më së paku nga ana e komunave (15 komuna).

Tabela 2. Dokumentet e publikuara të indeksit për transparencë buxhetore komunale 2022

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	Dokument i skanuar	Kërkesa	TOTAL
Raporti financiar TM 1 për vitin aktual	19	1	11	0	31
Raporti financiar TM 2 për vitin aktual	21	1	10	0	32
Raporti financiar TM 3 për vitin aktual	21	1	7	0	29
Raporti vjetor financiar për vitin aktual	21	2	6	0	29
Buxheti i planifikuar për vitin pasardhës	20	5	6	0	31
Korniza Afatmesme Buxhetore	16	3	13	0	32
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin aktual	11	1	15	2	29
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin aktual	11	1	2	1	15
Kontratat e nënshkruara 2022	11	6	12	0	29

Bazuar në formatin e publikimit të dokumenteve buxhetore, Komuna e Mitrovicës së Jugut i ka të publikuara të gjitha dokumentet buxhetore në formatin 'Excel/Word' që mundëson qasje dhe përdorim më të lehtë të të dhënave të publikuara. Komuna e Lipjanit, Prizrenit dhe Suharekës janë komuna të cilat kanë publikuar 90% të dokumenteve buxhetore në formatin 'Excel/Word'. Kryesisht, këto komuna rregulloren për ndarjen e subvencioneve e kanë të publikuar në formatin 'dokument i skanuar'. Në anën tjetër, komuna e vetme e cila i ka të gjitha dokumentet e publikuara në formatin 'dokument i skanuar' është Komuna e Obliqit. Komuna e Deçanit është komuna e dytë me numrin më të madh të dokumenteve të publikuara në format të skanuar (90%), e pasuar nga ajo e Kaçanikut (60%) dhe Kamenicës (50%).

Tabela 3. Komunat që publikojnë më shumë nga dokumentet buxhetore në formatin Excel apo Dokument i skanuar

Komuna	Excel/Word	Komuna	Dokument i skanuar
Mitrovicë e Jugut	100%	Obiliq	100%
Lipjan	90%	Deçan	90%
Prizren	90%	Kaçanik	60%
Skënderaj	90%	Kamenicë	50%

Analiza e performancës së komunave – indeksi i vitit 2022 krahasuar me indeksin e vitit 2021

Në indeksin e vitit 2022, 17 komuna kanë shënuar progres në renditje krahasuar me vitin 2021, ndërsa 12 komuna kanë shënuar regres në renditje. Pjesa e mbetur e komunave e ka të njëjtën renditje sikur në vitin 2021.

Komuna e Skënderajt është komuna me progresin më të madh në renditje, e cila për dallim prej vitit 2021 kur renditej e 23-ta, në indeksin e vitit 2022 renditet në pozitën e parë së bashku me pesë komuna të tjera, dallim ky me 22 pozita (+42.5 pikë), Komuna e Kamenicës është komuna e dytë me progresin më të madh në renditje krahasuar me vitin 2021 (+11 pozita), e pasuar nga Prizreni (+9 pozita), Vushtrria (+ 8 pozita) dhe Klina (+7 pozita). Në anën tjetër, regresin më të madh në renditje për vitin 2022 e ka shënuar Kaçaniku (-14 pozita), Obiliqi (-10 pozita), Graçanica (-10 pozita), Gjilani (-9 pozita) dhe Malisheva (-8 pozita).

Tabela 4. Komunitat me progresin dhe regresin më të madh në renditjen e indeksit të transparencës buxhetore

Komuna	Rangimi 2022	Rangimi 2021	Dallimi
Skënderaj	1	23	22 ▲
Kamenica	13	24	11 ▲
Prizren	1	10	9 ▲
Vushtrri	9	17	8 ▲
Klina	1	8	7 ▲
Malishevë	20	12	-8 ▼
Gjilan	17	8	-9 ▼
Graçanicë	24	14	-10 ▼
Obiliq	24	14	-10 ▼
Kaçanik	24	10	-14 ▼

Që nga fillimi i publikimit të Indeksit të GAP për Transparencë Buxhetore në vitin 2017, komunat tani kanë bërë progres në rritjen e transparencës së tyre buxhetore. Krahasuar me vitin 2021, gjatë vitit 2022 del se komunat kanë publikuar më shumë dokumente buxhetore, si dhe kanë mbajtur më shumë dëgjime publike buxhetore me qytetarë. Secili dokument buxhetor ka shënuar rritje në numrin e publikimit nga komunat krahasuar me vitin e kaluar me përjashtim të raportit vjetor financiar dhe rregullores për ndarje të subvencioneve, të cilat edhe këtë vit janë publikuar nga numri i njëjtë i komunave si në vitin 2021. Viti 2022 njëherit shënon edhe vitin me më së shumti dëgjime buxhetore të mbajtura mes komunave dhe qytetarëve për buxhetin e vitit pasardhës që prej vitit 2016.

Tabela 5. Numri i publikimit të dokumenteve dhe dëgjimeve buxhetore nga komunat

Dokumenti	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Raporti financiar TM 1 për vitin aktual	25	25	30	30	28	28	31
Raporti financiar TM 2 për vitin aktual	25	27	29	29	29	30	32
Raporti financiar TM 3 për vitin aktual	23	23	29	27	29	24	29
Raporti vjetor financiar për vitin aktual	27	28	33	34	30	29	29
Buxheti i planifikuar për vitin pasardhës	24	29	30	35	34	28	31
Korniza Afatmesme Buxhetore	22	22	30	31	32	29	32
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	23	28	30	33	32	30	30
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin aktual	23	21	27	25	24	20	29
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin aktual	6	4	8	9	7	8	15
Dëgjim buxhetor me qytetarë për vitin pasardhës	87	91	109	121	84	106	130

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor

Në Kosovë, barazia gjinore është një nga vlerat kushtetuese, por në praktikë, shoqëria mbetet diskriminuese ndaj grave si në fushën e politikës, tregun e punës ashtu edhe në përfitimet nga fondet publike.⁵

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L-020 për barazi gjinore, institucionet e Kosovës janë përgjegjëse për përfshirjen e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve.⁶ Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor është integrimi gjinor në proceset buxhetore, që nënkupton vlerësimin e buxhetit në bazë të gjinisë në të gjitha nivelet e procesit buxhetor dhe mundëson alokim më efikas të shpenzimeve publike duke e ulur kështu pabarazinë gjinore brenda komunave.

Për përgatitjen e buxhetit të Kosovës, për vitin aktual dhe planifikimin e hershëm për tre vitet e ardhshme, Ministria e Financave lëshon qarkoret buxhetore me udhëzime. Që nga viti 2018, në këto qarkore përfshihet edhe buxhetimi i përgjegjshëm gjinor i cili detyron organizatat buxhetore të bëjnë të dukshme efektet e shpenzimeve në barazinë gjinore në buxhetin vjetor, si dhe në qarkoret e brendshme buxhetore komunale si dokument bazë për planifikimin e buxhetit për tri vitet e ardhshme.⁷

Ndonëse, buxhetimi gjinor nuk është futur në vlerësimin e komunave për transparencë buxhetore, Instituti GAP edhe këtë vit, ngjashëm si në vitin e kaluar ka analizuar se sa nga komunat kanë të publikuara dokumente për buxhetim të përgjegjshëm gjinor. Nga gjetjet e raportit del se gjatë vitit 2022, komunat e Kosovës kanë bërë progres mjaft të madh sa i përket publikimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Për dallim prej vitit 2021, ku vetëm 12 komuna (31.6%) kishin të publikuar këtë dokument buxhetor, gjatë vitit 2022, 22 komuna (57.9%) kanë publikuar në ueb-faqen e tyre zyrtare apo i kanë dërguar përmes kërkesës tabelat për buxhetim të përgjegjshëm gjinor. Të gjitha 16 komunat e mbetura (42.1%) që nuk e kanë publikuar buxhetimin gjinor në vitin 2022 nuk e kanë pasur të publikuar të njëjtin dokument buxhetor as në vitin paraprak.

⁵ Instituti GAP. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor në komuna. Burimi: <https://bit.ly/GAP-BPGj>

⁶ Ligji nr. 05/L-020 për barazi gjinore. Burimi: <https://bit.ly/3SO9oGd>

⁷ Qarkorja buxhetore 2018/01. Burimi: <https://bit.ly/46TVlpS>

Tabela 6. Publikimi i dokumenteve për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor nga komunat për vitin 2021 dhe 2022

Komuna	Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor 2021	Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor 2022
Deçan	✓	✓
Dragash	✓	✓
Drenas	✓	✓
Ferizaj	✗	✓
Fushë Kosovë	✗	✗
Gjakovë	✓	✓
Gjilan	✗	✓
Graçanicë	✓	✓
Hani i Elezit	✗	✓
Istog	✗	✓
Junik	✓	✓
Kaçanik	✓	✓
Kamenicë	✗	✓
Klinë	✗	✓
Klllokot	✗	✗
Leposaviç	✗	✗
Lipjan	✓	✓
Malishevë	✗	✗
Mamushë	✗	✗
Mitrovicë e Jugut	✓	✓
Mitrovicë e Veriut	✗	✗
Novobërdë	✗	✗
Obiliq	✓	✓
Partesh	✗	✗
Pejë	✗	✗
Podujevë	✓	✓
Prishtinë	✗	✗
Prizren	✗	✗
Rahovec	✗	✓
Ranillug	✗	✗
Shtërpçë	✗	✗
Shtime	✓	✓
Skenderaj	✗	✓
Suharekë	✗	✓
Viti	✗	✗
Vushtrri	✗	✓
Zubin Potok	✗	✗
Zveçan	✗	✗

Përfundim dhe rekomandime

Transparenca buxhetore e komunave në vitin 2022 është në një nivel më të lartë se në vitet e kaluara, me 58% të komunave që kanë kaluar nivelin mesatar të pikëve të indeksit. Shtatë komuna kanë arritur maksimumin e pikëve të indeksit prej 100 pikë për vitin 2022, ndërsa katër komuna nuk kanë publikuar asnjë dokument buxhetor dhe janë vlerësuar me zero pikë në indeks. Dokumentet më të publikuara nga komunat për vitin 2022 janë raporti financiar për TM2 dhe korniza afatmesme buxhetore, ndërsa dokumenti më i vlerësuar me pikë në indeks, kartela analitike e kontos, është publikuar nga vetëm 15 komuna.

Ndonëse ky vit shënon progres në transparencën buxhetore të komunave, niveli i transparencës në komunat e Kosovës mund të konsiderohet ende i dobët si rezultat i mospublikimit të të gjitha dokumenteve buxhetore. Nga 38 komuna sa i ka Kosova, vetëm 15 prej tyre (39%) i kanë publikuar të gjitha dokumentet buxhetore që obligohen t'i publikojnë sipas Udhëzimit administrativ të MAPL-së për transparencë buxhetore në komuna. Duke u bazuar në gjetjet e vazhdueshme nga këto raporte, Instituti GAP rekomandon që:

- Publikimi i dokumenteve buxhetore në faqet zyrtare të internetit të komunave të bëhet brenda afateve kohore të përcaktuara edhe me Ligjin për qasje në dokumentet publike;
- Komunat duhet të publikojnë dokumentet në formate të lehta për tu lexuar dhe shkarkuar nga përdoruesit;
- MAPL duhet të monitorojë dhe nxisë implementimin e Udhëzimit Administrativ nr. 03/2020 për transparencë në komuna, konkretisht a) për të vlerësuar nëse janë duke u publikuar dokumentet e kërkuara buxhetore nga komunat, dhe b) nëse të njëjtat janë publikuar në bazë të fushave;
- Të bëhet krijimi i seksioneve të veçanta në ueb-faqet e komunave. Duke qenë që pjesa më e madhe e komunave nuk i ka të strukturuar mirë dokumentet e publikuara, komunat mund të krijojnë seksione të veçanta në ueb-faqen e tyre zyrtare të dedikuara enkas për të publikuar informacion mbi buxhetin dhe dokumentet buxhetore të tyre.
- Komunat të angazhohen më shumë për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjime buxhetore dhe të publikojnë procesverbalet e dëgjimeve buxhetore.

Anekset

Drenas	15
Klinë	16
Lipjan	17
Mitrovicë e Jugut	18
Prizren	19
Rahovec	20
Skënderaj	21
Hani i Elezit	22
Vushtrri	23
Podujevë	24
Suharekë	25
Gjakovë	26
Kamenicë	27
Istog	28
Prishtinë	29
Junik	30
Gjilan	31
Pejë	32
Ferizaj	33
Malishevë	34
Dragash	35
Shtime	36
Deçan	37
Graçanicë	38
Kaçanik	39
Obliq	40
Viti	41
Fushë Kosovë	42
Mamushë	43
Ranillug	44
Novobërdë	45
Klllokot	46
Shtërpcë	47
Partesh	48

Drenas

1/38

Bazuar në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore, komuna e Drenasit është renditur si komuna e parë më transparente për vitin 2022 së bashku me Komunën e Skënderajit, Prizrenit, Lipjanit, Klinës, Rahovecit, dhe Mitrovicës së Jugut. Shumicën e dokumenteve që vlerësohen me pikë maksimale i ka të publikuara në formatin 'Excel/Word' që mundëson qasje dhe përdorim më të lehtë të të dhënave të publikuara. Dy dokumentet e vetme të cilat janë të publikuara në formatin 'PDF' nga kjo komunë janë rregullorja për ndarjen e subvencioneve dhe kontratat e nënshkruar për vitin 2022, të cilat edhe pse janë të publikuara në këtë format vlerësohen me pikë maksimale, meqë ende nuk janë obligime ligjore për publikim. Në anën tjetër, në ueb-faqen zyrtare të saj, kjo komunë ka të publikuar edhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në formatin 'dokument i skanuar', tek i cili paraqitet numri i të punësuarve, numri i përfituesve të subvencioneve, si dhe shpërndarja e pagave dhe subvencioneve mes grave dhe burrave. Kjo komunë ka mbajtur të paktën katër dëgjime buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2023 dhe është përgjigjur në kërkesën për qasje në dokumente zyrtare nga Institutit GAP.

Tabela 7. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Drenasit

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	Dokument i Skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2022	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2022	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2022	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2022	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2023	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve		5		
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2022	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2022	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2023–2025	10			
Kontratrat e nënshkruara 2022		10		
Gjithsej	85	15		
<i>Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor</i>			✓	

Indeksi:
100

Klinë

1/38

Bazuar në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore, Komuna e Klinës me maksimum pikë të fituara së bashku me Komunën e Drenasit, Lipjanit, Mitrovicës së Jugut, Rahovecit, Skënderajit dhe Prizrenit është renditur si komuna më transparente në Kosovë për vitin 2022. Kjo komunë, në formatin 'Excel/Word' ka publikuar raportet financiare (TM1, TM2 dhe TM3), raportin vjetor financiar, buxhetin e planifikuar për vitin 2023, listën e përfituesve të subvencioneve për vitin 2022, kartelën analitike të kontos dhe kornizën afatmesme buxhetore. Ndërsa, në formatin 'dokument i skanuar', Komuna e Klinës ka të publikuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve, si dhe kontratat e nënshkruara për vitin 2022. Përveç kësaj, në ueb-faqen zyrtare të saj, kjo komunë ka të publikuar edhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në formatin 'Word', tek i cili paraqitet numri i të punësuarve, numri i përfituesve të subvencioneve, si dhe shpërndarja e pagave dhe subvencioneve mes grave dhe burrave.

Kjo komunë, në faqen e saj zyrtare, ka njoftuar për mbajtjen e së paku katër dëgjimeve buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2023 dhe është përgjigjur në kërkesën për qasje në dokumente zyrtare nga Instituti GAP.

Tabela 8. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Klinës

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	Dokument i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2022	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2022	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2022	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2022	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2023	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve			5	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2022	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2022	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Korniza Afatmesme Buxhetore 2023–2025	10			
Kontratat e nënshkruara 2022			10	
Gjithsej	75	0	25	
Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor	✓			

Indeksi:
100

Lipjan

1/38

Komuna e Lipjanit në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore të vitit 2022, me maksimum pikë të fituara është renditur si komuna më transparente në Kosovë për këtë vit së bashku me Komunën e Drenasit, Klinës, Mitrovicës së Jugut, Prizrenit, Rahovecit dhe Skënderajit. Kjo komunë pjesën më të madhe të dokumenteve buxhetore si raportet tremujore (TM1, TM2 dhe TM3), raportin vjetor financiar, buxhetin e planifikuar për vitin 2023, listën e përfituesve të subvencioneve, kartelën analitike të kontos, kornizën afatmesme buxhetore dhe kontratat e nënshkruara i ka të publikuara në formatin 'Excel/Word' që mundëson qasje dhe përdorim më të lehtë të të dhënave të publikuara nga palët e interesuar. Ndërsa, në formatin 'dokument i skanuar' ka të publikuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve. Poashtu, Komuna e Lipjanit në ueb-faqen e saj zyrtare ka të publikuar edhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor të vitit 2022, tek i cili paraqitet numri i të punësuarve, shuma e subvencioneve të ndara, si dhe shpërndarja e pagave dhe subvencioneve në vlera monetare mes grave dhe burrave.

Kjo komunë, në faqen e saj zyrtare, ka njoftuar për mbajtjen e së paku katër dëgjimeve buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2023 dhe është përgjigjur në kërkesën për qasje në dokumente zyrtare nga Instituti GAP.

Tabela 9. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Lipjanit

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	Dokument i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2022	5	0	0	0
Raporti financiar TM 2 për vitin 2022	5	0	0	0
Raporti financiar TM 3 për vitin 2022	5	0	0	0
Raporti vjetor financiar për vitin 2022	15	0	0	0
Buxheti i planifikuar për vitin 2023	5	0	0	0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	0	0	5	0
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2022	10	0	0	0
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2022	20	0	0	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	0	0	2.5	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	0	0	2.5	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	0	0	2.5	0
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	0	0	2.5	0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2023–2025	10	0	0	0
Kontratat e nënshkruara 2022	10	0	0	0
Gjithsej	85	0	15	0
Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor	✓			

Indeksi:
100

Mitrovicë e Jugut

1/38

Bazuar në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore, Komuna e Mitrovicës së Jugut së bashku me atë të Drenasit, Klinës, Lipjanit, Rahovecit, Skënderajit, dhe Prizrenit është renditur si komuna më transparente në Kosovë për vitin 2022. Kjo komunë të gjitha dokumentet e rëndësishme buxhetore i ka të publikuara në formatin 'Excel/Word' gjë që mundëson qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave të publikuara nga palët e interesuara. Komuna e Mitrovicës së Jugut, ndër të tjera në ueb-faqen e saj zyrtare ka të publikuar në formatin 'Word' edhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në të cilin paraqitet numri i të punësuarve, numri i përfituesve të subvencioneve, si dhe shpërndarja e pagave dhe subvencioneve në vlera monetare mes grave dhe burrave.

Kjo komunë, në faqen e saj zyrtare, ka njoftuar për mbajtjen e së paku katër dëgjimeve buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2023 dhe është përgjigjur në kërkesën për qasje në dokumente zyrtare nga Instituti GAP.

Tabela 10. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Mitrovicës së Jugut

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	Dokument i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2022	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2022	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2022	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2022	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2023	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	5			
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2022	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2022	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2023–2025	10			
Kontratat e nënshkruara 2022	10			
Gjithsej	100	0	0	
<i>Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor</i>	✓			

Indeksi:
100

Prizren

1/38

Komuna e Prizrenit është një tjetër komunë e cila ka shënuar progres të madh në indeksin e transparencës buxhetore 2022 krahasuar me indeksin e vitit 2021. Kjo komunë në indeksin e vitit 2022, bën pjesë në kuartilin e lartë dhe me maksimum pikë të fituara është renditur si komuna më transparente në Kosovë për vitin 2022 së bashku me Komunën e Drenasit, Klinës, Lipjanit, Mitrovicës së Jugut, Skënderajit dhe Rahovecit. Shumicën e dokumenteve buxhetore si: raportet financiare TM1, TM2 dhe TM3, raportin vjetror financiar për vitin 2022, buxhetin e planifikuar për vitin 2023, listën e përfituesve të subvencioneve, kartelën analitike të kontos, kornizën afatmesme buxhetore, si dhe kontratat e nënshkruara i ka të publikuara në formatin 'Excel/Word', që mundëson qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave të publikuara nga palët e interesuara. Në formatin 'PDF', Komuna e Prizrenit ka të publikuar rregulloren për ndarje të subvencioneve. Në anën tjetër, te ueb-faqja zyrtare e Komunës së Prizrenit nuk kemi gjetur të publikuar buxhetimin e përgjegjshëm gjinor i cili do të duhej të paraqiste numrin e të punësuarve, shumën e subvencioneve, si dhe shpërndarjen e pagave dhe subvencioneve mes burrave dhe grave.

Kjo komunë, në faqen e saj zyrtare, ka njoftuar për mbajtjen e së paku katër dëgjimeve buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2023 dhe është përgjigjur në kërkesën për qasje në dokumente zyrtare nga Instituti GAP.

Tabela 11. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Prizrenit

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	Dokument i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2022	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2022	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2022	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2022	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2023	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve			5	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2022	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2022	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025	10			
Kontratrat e nënshkruara 2022	10			
Gjithsej	95		5	
<i>Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor</i>				

Indeksi:
100

Rahovec

1/38

Komuna e Rahovecit edhe këtë vit ngjashëm si në vitin e kaluar ka arritur të mbledh pikë maksimale në vlerësimin për transparencë buxhetore të Institutit GAP. Kjo komunë, së bashku me Komunën e Drenasit, Klinës, Lipjanit, Mitrovicës së Jugut, Skënderajit, dhe Prizrenit prijnë si komunat më transparente në Kosovë për vitin 2022. Të gjitha dokumentet e vlerësuara me pikë maksimale në indeks me përjashtim të rregullores për ndarjen e subvencioneve janë në formatin 'Excel/Word', i cili lejon qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave të publikuara. Në anën tjetër, buxhetimin e përgjegjshëm gjinor të vitit 2022, kjo komunë e ka të publikuar në kuadër të kornizës afatmesme buxhetore, tek e cila paraqitet numri i të punësuarve, shuma e subvencioneve të ndara, si dhe shpërndarja e pagave mes grave dhe burrave.

Kjo komunë, në faqen e saj zyrtare, ka njoftuar për mbajtjen e së paku katër dëgjimeve buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2023 dhe është përgjigjur në kërkesën për qasje në dokumente zyrtare nga Instituti GAP.

Tabela 12. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Rahovecit

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	Dokument i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2022	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2022	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2022	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2022	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2023	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve			5	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2022	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2022	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025	10			
Kontratat e nënshkruara 2022	10			
Gjithsej	95	0	5	
<i>Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor</i>		✓		

Indeksi:
100

Skënderaj

1/38

Komuna e Skënderajt në Indeksin për transparencë buxhetore 2022, me maksimum pikë të fituara së bashku me Komunën e Drenasit, Lipjanit, Prizrenit, Klinës, Rahovecit, dhe Mitrovicës së Jugu është renditur si komuna më transparente në Kosovë për vitin 2022. Kjo komunë raportet financiare për tremujor (TM1, TM2 dhe TM3), raportin vjetor financiar, buxhetin e planifikuar për vitin 2023, listën e përfituesve të subvencioneve, kartelen analitike të kontos, kornizën afatmesme buxhetore, si dhe kontratat e nënshkruara i ka të publikuara në formatin 'Excel/Word', që mundëson qasje dhe përdorim më të lehtë të të dhënave të publikuara. Ndërsa, në formatin 'dokument i skanuar' ka të publikuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve e cila edhe pse është e publikuar në këtë format vlerësohet me pikë maksimale, meqë ende nuk është obligim ligjor për publikim. Në anën tjetër, kjo komunë në ueb-faqen e saj zyrtare ka të publikuar edhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në formatin 'Word', tek i cili paraqitet numri i të punësuarve, numri i përfituesve të subvencioneve, si dhe shpërndarja e pagave dhe subvencioneve në vlera monetare mes burrave dhe grave.

Kjo komunë ka mbajtur të paktën katër dëgjime buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2023 dhe është përgjigjur në kërkesën për qasje në dokumente zyrtare nga Instituti GAP.

Tabela 13. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Skënderajt

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	Dokument i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2022	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2022	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2022	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2022	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2023	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve			5	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2022	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2022	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Korniza Afatmesme Buxhetore 2023–2025	10			
Kontratat e nënshkruara 2022	10			
Gjithsej	85	0	15	
<i>Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor</i>	✓			

Indeksi:
100

Hani i Elezit

8/38

Bazuar në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore, Komuna e Hanit të Elezit është renditur si komuna e 8-të më transparente për vitin 2022 me gjithsej 95 pikë të mbledhura. Të gjitha dokumentet e vlerësuara janë publikuar në faqen zyrtare të komunës dhe shumica prej tyre janë në formatin 'Excel/Word', i cili lejon qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave të publikuara nga palët e interesuara. Në formatin 'dokument i skanuar', Komuna e Hanit të Elezit ka të publikuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve, listën e përfituesve të subvencioneve, si dhe kontratat e nënshkruara për vitin 2022. Në po këtë format, kjo komunë ka të publikuar edhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor tek i cili paraqitet numri i të punësuarve, numri i përfituesve të subvencioneve, si dhe shpërndarja e pagave dhe subvencioneve në vlera monetare mes grave dhe burrave.

Kjo komunë, në faqen e saj zyrtare, ka njoftuar për mbajtjen e së paku katër dëgjimeve buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2023 dhe është përgjigjur në kërkesën për qasje në dokumente zyrtare nga Instituti GAP.

Tabela 14. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Hanit të Elezit

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	Dokument i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2022	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2022	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2022	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2022	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2023	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve			5	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2022			5	
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2022	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Korniza Afatmesme Buxhetore 2023–2025	10			
Kontratat e nënshkruara 2022			10	
Gjithsej	65		30	
Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor			✓	

Indeksi:
95

Vushtrri

9/38

Bazuar në indeksin e GAP për transparencë buxhetore, Komuna e Vushtrrisë për vitin 2022 është renditur si komuna e 9-të më transparente në Kosovë me gjithsej 93.5 pikë të mbledhura. Kjo komunë në formatin 'Excel/Word' i cili lejon qasje dhe përdorim të lehtë të të dhënave të publikuara ka të publikuar raportet financiare (TM1, TM2 dhe TM3), raportin vjetor financiar, kornizën afatmesme buxhetore, kartelën analitike të kontos, si dhe kontratat e nënshkruara. Në formatin 'PDF' kjo komunë ka të publikuar buxhetin e planifikuar për vitin 2023. Ndërsa në formatin 'dokument i skanuar', Komuna e Vushtrrisë ka publikuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve, listën e përfituesve të subvencioneve, si dhe kontratat e nënshkruara. Gjithashtu, Komuna e Vushtrrisë në ueb-faqen e saj zyrtare e ka të publikuar edhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në formatin 'Word' tek i cili paraqitet numri i të punësuarve, shuma e subvencioneve të ndara, si dhe shpërndarja e pagave dhe subvencioneve mes burrave dhe grave.

Kjo komunë, në faqen e saj zyrtare, ka njoftuar për mbajtjen e së paku katër dëgjimeve buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2023 dhe është përgjigjur në kërkesën për qasje në dokumente zyrtare nga Instituti GAP.

Tabela 15. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Vushtrrisë

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	Dokument i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2022	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2022	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2022	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2022	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2023		3.5		
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve			5	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2022			5	
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2022	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Korniza Afatmesme Buxhetore 2023–2025	10			
Kontratat e nënshkruara 2022	10			
Gjithsej	70	3.5	20	
Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor	✓			

Indeksi:
93.5

Podujevë

10/38

Bazuar në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore, Komuna e Podujevës me 92.5 pikë të fituara është renditur si komuna e 10-të më transparente për vitin 2022. Kjo komunë, në formatin 'Excel/Word' ka publikuar raportet financiare (TM1, TM2 dhe TM3), raportin vjetor financiar, kartelen analitike të kontos, si dhe kornizën afatmesme buxhetore. Në formatin 'PDF' kjo komunë ka të publikuar vetëm një dokument atë të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2022. Ndërsa, në formatin 'dokument i skanuar' ka publikuar buxhetin e planifikuar për vitin 2023, rregulloren për ndarjen e subvencioneve, si dhe listën e përfituesve të subvencioneve. Përveç kësaj, në formatin 'dokument i skanuar' kjo komunë ka të publikuar edhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor tek i cili paraqitet numri i të punësuarve, numri i përfituesve të subvencioneve, si dhe shpërndarja e pagave dhe subvencioneve në vlera monetare mes grave dhe burrave.

Kjo komunë, në faqen e saj zyrtare, ka njoftuar për mbajtjen e së paku katër dëgjimeve buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2023 dhe është përgjigjur në kërkesën për qasje në dokumente zyrtare nga Institutit GAP.

Tabela 16. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Podujevës

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	Dokument i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2022	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2022	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2022	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2022	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2023			2.5	
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve			5	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2022			5	
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2022	20			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Korniza Afatmesme Buxhetore 2023–2025	10			
Kontratat e nënshkruara 2022		10		
Gjithsej	60	10	22.5	
<i>Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor</i>				✓

Indeksi:
92.5

Suharekë

11/38

Komuna e Suharekës në indeksin për transparencë buxhetore 2022, me 85 pikë të fituara bën pjesë në kuartilin e mesëm të lartë që në indeks marrin 70.5 pikë apo më shumë, duke u renditur kështu si komuna e 11-të më transparente në Kosovë. Kjo komunë në ueb-faqen zyrtare të saj në formatin 'Excel/Word' ka të publikuar raportet financiare (TM1, TM2 dhe TM3), raportin vjetor financiar, buxhetin e planifikuar për vitin 2023, si dhe kornizën afatmesme buxhetore. Në formatin 'dokument i skanuar', Komuna e Suharekës ka të publikuar rregulloren për ndarjen e subvencioneve, si dhe kontratat e nënshkruara për vitin 2022. Në anën tjetër përmes kërkesës kjo komunë ka dërguar edhe listën e përfituesve të subvencioneve për vitin 2022 dhe kartelen analitike të kontos. Përveç kësaj, përmes kërkesës Komuna e Suharekës ka dërguar përmes emailit edhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor tek i cili paraqitet numri i të punësuarve, përfituesve të subvencioneve, si dhe shpërndarja e subvencioneve në vlera monetare mes burrave dhe grave.

Kjo komunë, në faqen e saj zyrtare, ka njoftuar për mbajtjen e së paku katër dëgjimeve buxhetore me qytetarët për buxhetin e vitit 2023 dhe është përgjigjur në kërkesën për qasje në dokumente zyrtare nga Instituti GAP.

Tabela 17. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Suharekës

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	Dokument i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2022	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2022	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2022	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2022	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2023	5			
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve			5	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2022				5
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2022				10
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023			2.5	
Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025	10			
Kontratat e nënshkruara 2022			10	
Gjithsej	45	0	25	15
<i>Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor</i>				✓

Indeksi:
85

Gjakovë

12/38

Bazuar në indeksin e Institutit GAP për transparencë buxhetore, Komuna e Gjakovës me 78.5 pikë të fituara është renditur si komuna e 12-të më transparente në Kosovë për vitin 2022. Kjo komunë dokumentet buxhetore si raportet financiare (TM1, TM2 dhe TM3), raportin vjetor financiar, listën e përfituesve të subvencioneve, si dhe kornizën afatmesme buxhetore i ka të publikuara në formatin 'Excel/Word' gjë që mundëson qasje dhe përdorim më të lehtë të të dhënave të publikuara nga palët e interesuara. Dokumentet e tjera buxhetore si buxheti i planifikuar për vitin 2023 është i publikuar në formatin 'PDF', ndërsa rregullorja për ndarjen e subvencioneve dhe kontratat e nënshkruara për vitin 2022 janë të publikuara në formatin 'dokument i skanuar'. I vetmi dokument buxhetor i pa publikuar nga kjo komunë mbetet kartela analitike e kontos. Në anën tjetër, kjo komunë ka të publikuar në formatin 'PDF' buxhetimin e përgjegjshëm gjinor tek i cili paraqitet numri i të punësuarve, shuma e subvencioneve të ndara, si dhe shpërndarja e pagave dhe subvencioneve në vlera monetare mes grave dhe burrave.

Kjo komunë ka mbajtur të paktën katër dëgjime buxhetore me qytetarë për buxhetin e vitit 2023 dhe nuk është përgjigjur në kërkesën për qasje në dokumente zyrtare nga Institutit GAP.

Tabela 18. Vlerësimi i detajuar për të gjitha dokumentet buxhetore të Komunës së Gjakovës

Dokumenti	Excel/ Word	PDF	Dokument i skanuar	Kërkesa
Raporti financiar TM 1 për vitin 2022	5			
Raporti financiar TM 2 për vitin 2022	5			
Raporti financiar TM 3 për vitin 2022	5			
Raporti vjetor financiar për vitin 2022	15			
Buxheti i planifikuar për vitin 2023		3.5		
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve			5	
Lista e përfituesve të subvencioneve për vitin 2022	10			
Kartela Analitike e Kontos për shpenzime të buxhetit për vitin 2022				
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	2.5			
Dëgjim buxhetor me qytetarë për buxhetin e vitit 2023	2.5			
Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025	10			
